



KËSHILLI DREJTUES I RTSH
NR. 2118 PROT

Tiranë më 16.09.2020

VENDIM
NR. 31, date 16.09.2020

Në zbatim të nenit 102 pikat 2/ç dhe 12 të ligjit nr 97/2013, datë 04.03.2013 “ Për median audiovizive ne RSH”, nenit 17 të vendimit të Kuvendit të Shqipërisë nr 98, datë 22.12.2016 “ Për miratimin e Statutit të RTSH”, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH me shkresën nr 2560 prot, date 08.09.2020, mbi miratimin e ndryshimeve në Strukturën Organizative të Qendrës Vendore Audiovizive të Radio Shkodrës për vitin 2020, Këshilli Drejtues i RTSH në mbledhjen e tij datë 16.09.2020 me votimin pro të 6 anëtarëve të pranishëm K.Traja, Xh.Aliu, Xh.Mato H.Haliti, S. Kumbaro, dhe A.Shegani;

VENDOSI:

I.Të miratojë ndryshimet në Strukturën Organizative të Qendrës Vendore Audiovizive të Radio Shkodrës si më poshtë vijon:

- Në Strukturën Organizative të Sektorit Teknik, një vend pune në emërtesën “Teknik montazhi & transmetimi” të ndryshojë në emërtesën “Përgjegjës transmetimi”.
- Në Strukturën Organizative të Sektorit Teknik, një vend pune në emërtesën “Teknik montazhi & arkivi” të ndryshojë në emërtesën “Teknik transmetimi TV i parë”.

Numri i vendeve të punës në Strukturën Organizative të Qendrës Vendore Audiovizive te Radio Shkodrës nuk ndryshon, mbetet 24.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KËSHILLIT DREJTUES TË RTSH

Kristaq TRAJA